



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 13-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 27.02.2023, në sallën numër 2, kati i 3-të, me fillim në ora 14⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Anila Reqica-Llugiqi DKRS
2. Safete Amerllahu, DGJK

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë me kohë, të cilën e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 12-të e Kuvendit.
2. Propozim vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15 .Nr.011-43473 të datës 28.06.2019
3. Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës së Lipjanit
4. Raporti Janar Dhjetor 2022, i punës së zyrës së kryetarit dhe drejtorateve komunale.

5. Propozim Vendim për aprovimin e listës së projekteve kapitale me prioritet për bashkëfinancim për vitin 2023

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Pasi që nuk pati plotësime as vërejtje, kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje duke e tëriqur pikën 2 dhe 3 nga rendit i ditës ,pastaj u konstatua se me të gjitha votat, 7 për, aprovoi rendin e ditës:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 12-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se unë kam diskutuar ne KPF dhe i kam dhënë disa propozime për pikat e rendit të ditës nuk me janë shënuar kërkoj që të përmirësohen .

Daut Azemi, tha se ne mbledhjen e kaluar nuk ka qenë Behari, por do të përmirësohet para publikimit në faqe të komunës.

Meqë vërejtje tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për:

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 12-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës

II

Propozim vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15 .Nr.011-43473 të datës 28.06.2019

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica –Llugiqi, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se me këtë rregullore po u humben kompetencat kuvendit, ku sipas kësaj janë dy aspekte e para, kryetarit po ja ep mundësinë vitin e ardhshëm me i dhanë subvencion kunja te dojë e dyta, kur është vlera mbi 2 mijë euro prapë po ja lejon kryetarin te nda kujt te dojë dhe mete po fuqizohet kompetenca e kryetarit.

Daut Azemi, kryesues i Kuvendit, tha se nuk po i humbin kompetencat kuvendit po ashtu na ka kërkuar ministria qe nëse ndahet buxheti nga Kuvendi, mos te ketë nevojë për te njëjtin prapë te dal në Kuvend.

Alban Salihu, tha se me këtë rregullore po i shtohen kompetencat kryetarit të komunës.

Anila Reqica-Llugiqi, tha se jo nuk po i shtohen kompetencat kryetarit me këtë rregullore.

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

III

Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safete Amerllahu DGJK e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

Propozim Vendim për aprovimin e listës së projekteve kapitale me prioritet për bashkëfinancim për vitin 2023

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemit, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që raporti t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15:20

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi